



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 33, datë 12.05.2020

**PËR
MIRATIMIN E PRISHJES SË DETYRUAR TË GODINËS SHKOLLA 9-VJEÇARE
“ADEM GJELI”, GJURICAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, DURRËS,
REKOMANUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË, SI DHE HEQJEN NGA
KONTABILITETI DHE LISTA PËRFUNDIMTARE E PRONAVE
TË KËSAJ GODINE**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 295, datë 02.05.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr.940 prot., datë 30.04.2020, ardhur nga Instituti i Ndërtimit, me lëndë “Dërgim Akt ekspertizë”, ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket shkollës 9- vjeçare “Adem Gjeli”, Gjuricaj, Njësia Administrative Ishëm, që mban nr.4, të listës së transferimit, që me VKM nr. 295, datë 02.05.2012, ka kaluar në pronësi të Komunës Ishëm (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019, riparimi nuk bëhet, dhe është rekomanduar të demolohet, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista përfundimtare e pronave të Njesisë Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, të pronës me nr. 4 që i përket shkollës 9- vjeçare “Adem Gjeli”, Gjuricaj, që me VKM nr. 295, datë 02.05.2012, ka kaluar në pronësi të Komunës Ishëm (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30,,datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me nr.4, që me VKM nr.295, datë 02.05.2012, ka kaluar në pronësi të Komunës Ishëm (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli) i liruar nga prishja e godinës e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e godinës, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, bazuar në normat dhe Kodet Europiane të Projektimit.
5. Shpenzimet për shembjen e godinës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, që bazuar në Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë Zbatuese (Fondin e Zhvillimit), që administron fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e godinës, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të godinës, pas realizimit të rindërtimit.



7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme Ligjore.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 12.05.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. ~~427~~ Prot.

Durrës, më 13 05.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 33, datë 12.05.2020 Për miratimin e prishjes së detyruar të godinës shkolla 9-vjeçare “Adem Gjeli”, Gjuricaj, njësia administrative Ishëm, Durrës, rekomanuar nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë, si dhe heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare e pronave të kësaj godine.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

